

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.13.04.2021*

13.04.2021
Ora 16:05

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për shqyrtimin e raportit të Autoritetit të Medias Audiovizive të pasqyrimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të për periudhën 26.03.2021-03.04.2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, V.Ballgjini, E.Allushi**
- **Parti Politike: PD, LSI, PDIU**

Z. I. Celibashi: Mirë vazhdojmë, sot në rendin e ditës kemi këto çështje:

Projektvendim “Për përdorimin e aplikacionit KQZ”;

Projektvendim “Për një ndryshim në vendimin nr. 148, datë 16.03.2021 “Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave, për zgjedhjet për kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”;

Projektvendim “Për lirim dhe emërim të një sekretari të KZAZ-së dhe të disa anëtarëve të KZAZ-ve”;

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vorë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë”.

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vorë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë”.

Projektvendime “Për miratimin e vëzhguesve, për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 prill 2021”.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.13.04.2021*

**13.04.2021
Ora 16:19**

RENDI I DITËS

Projektudhëzim “Për përdorimin e aplikacionit KQZ”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z.Illirjan Celibashi


2.Stafi KQZ: Y.Merkaj, M.Koja, V.Ballgjini, E.Allushi

• **Parti Politike: PD, LSI**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Me vendimin nr.11, datë 25.03.2021, Komisioni Rregullator ka përcaktuar në nenin 38, pika 5 se anëtarët e Komisionit të Qendrës së Votimit dhe operatorët teknik për raportimin, informimin e aspekteve procedurale që lidhen me zbatimin e procesit të punës të përcaktuar në këtë vendim përdorin paralelisht edhe mjetet dhe platformat e ndërveprimit elektronik sipas udhëzimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Referuar kësaj pike të vendimit të Komisionit Rregullator është përgatitur projektudhëzimi “Për përdorimin e programit aplikativ KQZ”. Gjatë ditës së votimit nga anëtarët e Komisionit Qendrës së Votimit dhe Komisionit të Zonës Administrimit Zgjedhor dhe operatorët e KQZ-së të ngarkuar me detyra të posaçme në qendrat e votimit. Nëpërmjet aplikacionit “KQZ”, anëtarët e KQV-së, ose të KZAZ-së dhe sipas rastit operatorët informojnë KQZ-në për ecurinë e votimit ose të numërimit e të nxjerrjes së rezultateve. Është përcaktuar gjithashtu se operatori, ka detyrim për dërgimin çdo një orë të informimit për pjesëmarrjen nëpërmjet “Skano QR Code”, sipas procedurave të përcaktuara në lidhjen 1. Ky informacion mundet të dërgohet në

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.13.04.2021*

KQZ edhe nga secili prej anëtarëve të Komisionit të Qendrës së Votimit, por në çdo rast pa penguar procesin e votimit dhe përdorimin e PEI nga operatori. Bashkëlidhur keni projektudhëzimin për shqyrtim dhe miratim si dhe lidhjet bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Z. I. Celibashi: Faleminderit, kemi ndonjë diskutim nga përfaqësuesit e partive politike? Nuk ka. Ky është një akt që sikurse e kemi bërë diskutimin dhe konsultuar dhe me përfaqësues të partive politike, ka për qëllim që t'i krijojmë mundësi anëtarëve të Komisionit të Qendrës së Votimit por dhe të KZAZ-së një mocion shumë për të dhënë informacion dhe për të dërguar informacion në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në mënyrë kategorike nuk zëvendëson asnjë prej dokumentave zgjedhor apo materialeve tjera zgjedhor që do të përdoren gjatë ditës së votimit. Thjesht është një opsion më shumë.

Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së: Duke qenë se ky ka ardhur sot dhe nuk kemi pasur as kohën e mjaftueshme ne që e kemi marrë në email ta shikojmë dhe për të pasur një rakordim pak më të drejtë në lidhje me projektvendimin e propozuar. Do të kërkoja që këtë ta shqyrtonim me një seancë tjetër në një datë sa më të afërme dhe të vimë të përgatitur dhe të jemi pak më të njohur qoftë me udhëzimin e përdorimit edhe me personat kush do të duhet ta përdorë atë ditë, sepse me një sy të shpejtë që kemi parë deri tani. Në pikën 1 i jepet për përdorim operatorit dhe në pikat e tjera nuk përjashtohen as anëtarët e tjerë të QV-ve apo të KZAZ-ve. Ta shikojmë, të njihemi dhe pastaj të japim dhe ne mendimet tona qoftë relatimet edhe para datës që ju do të caktoni dhe të jetë një akt i pranueshëm nga të gjithë dhe më shumë për t'u kuptuar sesi do të funksionojë.

Z. I. Celibashi: Faleminderit, e shtyjmë vendimmarrjen dhe për këtë pikë të rendit të ditës.

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2021*

**15.04.2021
Ora 16:13**

RENDI I DITËS

Projektudhëzim: “Përdorimi i aplikacionit KOZ”


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve** **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ:** **Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi**
- **Parti Politike:** **PD, LSI, PDIU**
- **Vëzhgues** **OSBE/ODIHR**

Z. I. Celibashi: Fillojmë seancën, në rendin e ditës janë për shqyrtim projektaktet: Pika e parë projektvendimi “Për një ndryshim në vendimin nr. 37; “Për miratimin e modeleve të dokumentacionit të punës të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”; pika e dytë e rendit të ditës ka të bëjë me Projektvendimin “Për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes të disa QV-ve, për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 prill 2021”; pika e tretë ka të bëjë me Projektvendimin “Për emërimin e sekretarit të KZAZ-së, lirim dhe emërim të sekretarit të KZAZ-së 26 Qarku Tiranë dhe disa anëtarëve të KZAZ-ve”. Pika e katërt është Projektvendimi “Për miratimin e rregullave procedurale e teknike për procesin e votimit dhe numërimit elektronik nëpërmjet pajisjes elektronike të votimit dhe numërimit në QV-të e ZAZ-së nr. 40 në Qarkun Tiranë, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”; pika e fundit është Projektvendimi “Për miratimin e vëzhguesve, për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 prill 2021”. Nga mbledhja e kaluar

1

**Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI**



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2021**

kemi dhe projektvendimin që ka të bëjë me “Miratimin e procedurave të aplikacionit KQZ”.

Z. Y. Merkaç: Kemi një propozim për të shtuar një pikë në rendin e ditës, është projektvendimi “Për një ndryshim në vendim nr.148 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për caktimin e vendodhjes së VNV-ve”. Bëhet fjalë për vendodhjen e VNV-së

Z. I. Celibashi: Dakord të shtohet! Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës që në fakt ka të bëjë me vazhdimin e shqyrtimit të projektudhëzuesin që ka të bëjë me “Përdorimin e aplikacionit KQZ”. Në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës përfaqësuesit e partive politike kanë ndonjë gjë?

Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së: Jemi dakord i nderuar lidhur me këtë pikë. Shprehemi dakord pasi u njohëm dhe mendojmë se ky aplikacion është në të mirë të gjithë procesit zgjedhor për atë ditë dhe të gjitha problemeve që mund të reflektojnë në kohë reale. Të cilat ngelen të pasqyruara edhe më vonë për zgjidhjen e problematikave që mund të krijohen në kohë të ankimeve më vonë. Kështu që mendojmë se duhet të kalojë sot ashtu siç akti është parashtruar nga ju, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit, diskutime të tjera? Nuk kemi, atëherë meqenëse edhe pas konsultimeve kemi dakordësinë e përfaqësuesve të partive politike në lidhje me projektaktin, Vendos:

Miratimin e udhëzimit sipas të cilit, Komisioneri udhëzon:

1. Përdorimin e programit aplikativ “KQZ” gjatë ditës së votimit, nga anëtarët e KQV-ve, KZAZ-ve dhe operatorët e KQZ-së të ngarkuar me detyra të posaçme në



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.04.2021**

qendrat e votimit, sipas procedurave të përcaktuara në lidhjen 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Përdorimi i aplikacionit “KQZ” nuk i përjashton anëtarët e KQV-së, ose sipas rastit të KZA-së nga detyrimi për përdorimin dhe mbajtjen e çdo dokumentacioni tjetër zgjedhor, si të tilla por pa u kufizuar, libri i protokollit të mbledhjeve të proces-verbale, etj.

3. Nëpërmjet aplikacionit “KQZ”, anëtarët e KQV-ve, ose të KZAZ-ve, si dhe sipas rastit operatorët informojnë KQZ-në për ecurinë e votimit dhe ose të numërimit e të nxjerrjes së rezultatit.


4. Operatori, ka detyrimin për dërgimin çdo një orë të informacionit mbi pjesëmarrjen nëpërmjet “Skano QR Code”, sipas procedurave të përcaktuara në lidhjen 1. Ky informacion mundet të dërgohet në KQZ edhe nga secili prej anëtarëve të KQV-së, por në çdo rast pa penguar procesin e votimit dhe përdorimin e PEI nga operatori.

5. Ngarkohen anëtarët e komisioneve të qendrave të votimit, të komisioneve të zonave të administrimit zgjedhor dhe operatorët e KQZ-së të ngarkuar me detyra të posaçme në qendrat e votimit për zbatimin e këtij udhëzimi.

6. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Udhëzim nr. 9

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.13.04.2021**

Si dhe nga seanca e djeshme kemi lënë pa shqyrtuar dhe projektvendimin që ka të bëjë me raportin e Autoritetit të Medias Audiovizive.

Fillojmë me pikën e rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e raportit të Autoritetit të Medias Audiovizive. Besoj përfaqësuesit e partive politike janë njohur nga dje. Kemi ndonjë diskutim tjetër shtesë veç atyre që diskutuam dje?

Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU-së: Zoti Kryetar, faleminderit! Nuk kam qenë në mbledhje dje, në qoftë se është e mundur do t'u kërkonim të na jepnit një mundësi për ta shqyrtuar ditën e nesërme, pasi do të më duhet të konsultohem me përfaqësuesin e partisë. Në qoftë se është e mundur të shtyhet për nesër në çfarëdo orari që do të dëshironi Ju për sa i përket projektvendimit "Për shqyrtimin e raportit të Autoritetit të Medias Audiovizive të pasqyrimin të fushatës zgjedhore..". për faktin se siç jeni në dijeni ne vazhdojmë ankesat tona në lidhje me nenin 65, pika 3. Tashmë jemi në Kolegjin Zgjedhor dhe kërkojmë kohë për të pasur një informacion më të saktë dhe një komunikim më të plotë me subjektin që unë përfaqësoj, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Kemi ndonjë diskutim tjetër nga përfaqësuesit e tjerë të partive politike, lidhur me këtë kërkesë?

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Është e drejtë e subjektit, është në vlerësim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ta vlerësojë kërkesën e subjektit. Pavarësisht se pjesën e fundit të fjalës së tij e lidhi me diçka që s'kishte lidhje në vetë vetë me shqyrtimin e këtij akti. Nuk kemi gjë tjetër!

Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU-së: Kryetar, për të mbajtur një raport pak korrekt midis përfaqësuesve të partisë. Para disa ditësh është kërkuar për një projektvendim

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.13.04.2021*

për t'u shtyrë dhe ne nuk kundërshtuam fare, prandaj nuk mendoj se ka nevojë për të diskutuar se është e drejtë apo nuk është e drejtë, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Duhet të sqarojmë një gjë, që ju keni gjithë mirëkuptimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të marrë pjesë në mbledhje, qoftë të Komisionerit, qoftë dhe të Komisionit Rregullator. Por, qëndruar strikt interpretimit të Kodit Zgjedhor, ju nuk përfaqësoni interes të ligjshëm në këto diskutime. Ju jeni përfaqësues i një partie politike që vërtet është e regjistruar në këto zgjedhje, por në fakt nuk merr pjesë si subjekt zgjedhor. Disa kandidatë të kësaj partie janë pjesë e një koalicioni. Gjithësesi për hatër të transparencës dhe të respektit personal ndaj jush, ne ju kemi dhënë mundësinë që të shprehni mendime dhe opinionin duke menduar se diskutimet tuaja i kontribuojnë mbarëvajtjes së përgatitjes së procesit zgjedhor. Më shumë akoma në lidhje me këtë projektvendim ju nuk tërhiqni asnjë lloj interesi të ligjshëm, pasi partia që ju përfaqësoni nuk është subjekt zgjedhor dhe nuk është subjekt i cili ka marrëdhënie me median e rrjedhimisht të jetë objekt i shqyrtimit nga ana e Komisionerit, apo dhe të monitorimit nga AMA. Partia që ju përfaqësoni është pjesë e këtij koalicioni dhe koha televizive, apo radiofonike është kohë e cila përfshihet në kohën e koalicionit në të cilin ju bëni pjesë. Të drejtat dhe detyrimet e këtij koalicioni në raport edhe me median, përfaqësohen nga partia udhëheqëse e koalicionit që është Partia Demokratike. Thënë dhe këtë të fundit, mendoj se nuk ka asnjë arsye që ta shtyjme. Ne, bazuar në kërkesën e përfaqësuesit të Partisë Demokratike, si parti udhëheqëse e koalicionit, dje e shtymë për sot vendimmarrjen. Mendoj se çdo ditë më shumë që e shtyjme, nuk është në interes të subjekteve zgjedhore të cilat kanë interesa të ligjshme në lidhje me mënyrën dhe kohën që sipas të cilës mediat përcjellin fushatën e tyre zgjedhore. Sa më shpejt KQZ të marrë një vendim, aq më mirë është për interesat e tyre, faleminderit për

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.13.04.2021**

mirëkuptimin! Kemi ndonjë diskutim tjetër në lidhje me përmbajtjen? Besoj se jeni njohur dhe me raportet ditore..

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Po, jemi njohur! Nuk di nëse ka ndonjë ndryshim nga akti që na është propozuar dje? Nuk shohim relacionin përkatës në qoftë se një gjë e tillë ka ndodhur. Është i njëjti akt, apo jo zoti Sekretar i Përgjithshëm? Kështu që të relatohet mbi të e të mbajmë qëndrimet tona.

Z. I. Celibashi: Nuk kemi asnjë ndryshim dhe asnjë informacion shtesë, apo jo zoti Sekretar?

Z. Y. Merkaçaj: Jo, nuk ka asnjë ndryshim.

Z. I. Celibashi: Mirë atëherë, duke deklaruar të mbyllur diskutimet në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës, bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 78, 80, 81, 83, 84 dhe 85, të Kodit Zgjedhor si dhe vendimin nr.2, datë 30.01.2021 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audiovizive”, Vendos:

1.T’u tërhiqet vëmendja, për respektimin e plotë të detyrimit ligjor për të depozituar pranë AMA-s regjistrime për periudhën 26.3.2021 – 3.4.2021, në zbatim të pikës 6, të nenit 85, të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr.2, datë 30.1.2021, të Komisionit Rregullator, për ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv si më poshtë vijon: TV Skampa - TV Adria Net - TV Channel 1 - TV Kopluku - TV Antena Nord - TV Klaudiana - TV Channel 7 - TV Jug - TV Gold - TV Glob - TV Puka - TV 4 - TV Mati - TV Bulqiza - TV Alpo - TV Rozafa - TV RE.AL - TV Apollon - TV Berati -

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.13.04.2021*

TV Sot 7 - TV Star Plus - TV Best Channel - TV 6+1 - One TV Vlora - TV Saranda
- TV Lobi - TV Kukësi - Zjarr TV.

2. Të bëjnë kompensim me kohë transmetimi në edicionet e lajmeve për balancim,
në zbatim të nenit 81, të Kodi Zgjedhor për operatorët e mëposhtëm:

RTSH - 135 min PD, 34 min LSI, 40 min PSD;

RTSH - 25 min PD, 4 min LSI, 7 min PSD;

TV Klan - 57 min PD, 61 min LSI, 73 min PSD;

TV Top Channel - 7 min PD, 20 min LSI, 20 min PSD;

TV Vizion Plus - 33 min PD, 39 min LSI, 44 min PSD;

RTSH 24 - 22 min PD, 20 min LSI, 23 min PSD;

Klan Plus - 26 min PD, 17 min LSI, 25 min PSD;

Klan Neës - 128 min PD, 75 min LSI, 105 min PSD;

Top Neës - 35 min PD, 41 min LSI, 48 min PSD;

Kanal 7 - 15 min PD, 14 min LSI, 19 min PSD;

News 24 - 20 min PD, 28 min LSI, 59 min PSD;

ABC News - 4 min PS, 18 min LSI, 25 min PSD;

RTV Ora - 17 min PD, 12 min LSI, 22 min PSD;

Report TV - 98 min PD, 59 min LSI, 75 min PSD;

TV Scan - 9 min PD, 49 min LSI, 49 min PSD;

TV Ora News - 22 min PD, 9 min LSI, 24 min PSD;

TV Shijak - 38 min PS, 85 min PSD;

Euro News Balkans - 5 min PS, 25 min LSI, 49 min PSD;

Fax News - 25 min PD, 14 min LSI, 29 min PSD;

Syri TV - 25 min PD, 43 min LSI, 73 min PSD;

TV Apollon - 21 min PD, 174 min LSI, 174 min PSD;

TV Alpo - 35 min PD, 35 min PSD;

Zbardhi materialin audio

Jona DERVISHI



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.13.04.2021*

A2 CNN - 18 min PD, 19 min LSI, 45 min PSD;
TV Bulqiza - 16 min PS, 19 min LSI, 29 min PSD;
TV Berati - 11 min PD, 18 min LSI, 18 min PSD;
RE.AL - 13 min PS, 50 min LSI, 36 min PSD;
MCN TV - 24 min PD, 26 min LSI, 24 min PSD;
TV Rozafa - 28 min PD, 29 min LSI, 65 min PSD;
TV Skampa - 9 min PD, 49 min LSI, 49 min PSD;
Zjarr TV - 10 min PS, 55 min PSD;
Adria Net - 17 min LSI, 17 min PSD;

Këto ish-in minutat për kompensim

Pika e tretë, ndërprerjen e transmetimit të reklamave politike jashtë intervaleve kohore të përcaktuara, për televizionet ky urdhërim: TV Klan, TV Vizion Plus, Klan News, ABC News, RTV Ora, Syri TV, A2 CNN, TV Shijak, TV Apollon, RE.AL. Pika 4, të ndërpritet menjëherë transmetimi i reklamave politike brenda edicioneve të lajmeve të Klan News, Alpo - RE.AL.

Pika 5. Subjekti televiziv RE.AL në zbatim të pikës 9, të nenit 84, të Kodit Zgjedhor, të ndërpresë transmetimin e reklamës politike për subjektin zgjedhor Partia Bindje Demokratike.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr.224

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.13.04.2021*

**13.04.2021
Ora 16:22**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për një ndryshim në vendimin nr. 148, datë 16.03.2021 “Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: Y.Merkaj, M.Koja, V.Ballgjini**
- **Parti Politike: PD,LSI**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Vendet e Numërimit të Votave për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 prill 2021, janë përcaktuar me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me nr. 148, datë 16 Mars 2021. Ku ndër të tjera edhe Vendin e Numërimit të Votave për KZAZ-në nr.4 është caktuar palestra e shkollës Azem Hajdari. Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresën nr.2/25 prot, datë 12.04.2021, ka propozuar ndryshimin e vendodhjes së KZAZ-së nga shkolla Azem Hajdari në palestrën e shkollës Ismail Qemali duke argumentuar se është ambienti më i përshtatshëm për vendin e numërimit të votave. Ka hapësirë më të madhe për të përmbushur masat anti-covid si dhe ka ndriçim dhe ajrosje të ambientit më të mirë se palestra e

1

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.13.04.2021*

shkollës Azem Hajdari. Propozimet e paraqitur nga prefekti, plotësojnë kërkesat e parashikuara në nenin 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor. Pasi palestra ka një sipërfaqe prej 635 m², si dhe ka një ambient të përshtatshëm për të përmbushur masat anti covid. Në këto kushte i propozoj Komisionerit Shtetëror të Zgjedhje që të pranojë propozimin e Prefektit të Qarkut Shkodër për ndryshimin e vendodhjes së VNV-së nga palestra e Shkollës Azem Hajdari në palestrën e shkollës 9-vjeçare Ismail Qemali, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Sa larg janë këto objekte nga njëra-tjetra?

Z. Y. Merkaç: Nuk janë shumë larg, 300 metra larg njëra-tjetrës.

Z. I. Celibashi: Edhe varianti i dytë i propozuar?

Z. Y. Merkaç: Po janë brenda zonës administrative, por shkolla Azem Hajdari është pak më në periferi të qytetit të Shkodrës, kjo është më afër qendrës. Për këtë është marrë dakordësia dhe nga partia politike dhe përfaqësuesve.

Z. I. Celibashi: Kemi ndonjë diskutim? Nuk kemi. Atëherë miratohet ndryshimi i vendodhjes së VNV-së për KZAZ-në nr.4, nga shkolla Azem Hajdari me palestrën e shkollës Ismail Qemali Shkodër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr. 225

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.13.03.2021*

**13.03.2021
Ora 16:24**

Projektvendim “Për lirim dhe emërimin e anëtarëve të KZAZ-së nr.22 Qarku Durrës dhe të KZAZ-së nr.72 Qarku Korçë dhe KZAZ-së nr.24 Qarku Durrës.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Ilirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, V.Ballgjini**
- **Parti Politike: PD,LSI**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër.

Z. Y. Merkaj: Bazuar në nenin 32 paragrafi 2, shkronja “d” e Kodit Zgjedhor, Partia Demokratike në datën 09.04.2021, ka kërkuar lirim dhe emërimin e anëtarëve të KZAZ-së nr.22 Qarku Durrës, të KZAZ-së nr.72 Qarku Korçë dhe të KZAZ-së nr.72 Qarku Korçë. Partia Socialiste me shkresën e datës 09.04.2021 dhe 12.04.2021, ka kërkuar lirim dhe zëvendësimin e anëtarëve të KZAZ-së nr.24, dhe lirim dhe zëvendësimin e dy anëtarëve të KZAZ-së nr.26. Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se propozimet janë në përputhje me nenin 30, 31, 32 të Kodit Zgjedhor. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit.

1

**Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.13.03.2021*

Z.I.Celibashi: Miratohet lirimi nga detyra e Sekretarit të KZAZ-së nr.22 dhe disa anëtarëve të KZAZ-ve. Sipas lidhjes nr.1 bashkëlidhur këtij vendimi emërohet Sekretari i KZAZ-së nr.22 sipas propozimit përkatës dhe anëtarëve të KZAZ-ve, sipas lidhjes 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe njoftohet KZAZ-ve përkatëse.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve nga momenti i shpallejes së këtij vendimi.

Vendimi nr.226

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.13.04.2021*

**13.04.2021
Ora 16:26**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vorë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, z. Misar Sherif Muka”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z.Ilirjan Celibashi
2.Stafi KQZ: Y.Merkaj, M.Koja, V.Ballgjini, E.Allushi
- **Parti Politike: PD, LSI**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër.

Z. Y. Merkaj: Këshilli i Bashkisë Vorë ka njoftuar KQZ për krijimin e vakancës nga Këshilltari zotin Arlind Aleksandër Papa, propozuar nga subjekti politik Partia Socialiste. Referuar nenit 164, pika 2 të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste e Shqipërisë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 21, zoti Misar Sherif Muka. Kandidati për këshilltar ka plotësuar formularin e vetëdeklarimit në KQZ me numër unik 2143. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë e cila ka të bëjë me parashikimet për ndalim në ligjin nr.138/2015. KQZ ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore dhe Zyra e Gjendjes Civile ku në përgjigje të kërkesës sonë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.13.04.2021*

gjendjes gjyqësore të kandidatit për anëtar të Këshillit të Bashkisë Vorë, i cili rezulton se nuk ka shënime në sistem. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk ka kthyer ende përgjigje. Referuar pikës 2, të kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se, të dhënat e kandidatit për anëtar, në Këshillin e Bashkisë Vorë, nuk përbëjnë kusht për mos zgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Diskutime nga përfaqësuesit e partive? Nuk kemi. Mirë, atëherë bazuar në nenin 19 pika 1 dhe vijues të Kodit Zgjedhor vendos:

- 1.Zoti Misar Sherif Muka kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Vorë nuk përfshihet në kushtet e mos gjetshmërisë për ushtrimin e funksionit;
- 2.Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vorë me kandidatin nga lista shumëmemërore PS zoti Misar Sherif Muka;
- 3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në KAS brenda 3 ditëve nga momenti i hyrjes së tij në fuqi dhe
- 4.Hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Vendimi nr.227

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.13.04.2021*

**13.04.2021
Ora 16:27**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vorë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zj. Grisilda Nexhip Plaka”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, V.Ballgjini, E.Allushi**
- **Parti Politike: PD, LSI**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër.

Z. Y. Merkaj: Këshilli i Bashkisë Vorë ka njoftuar KQZ për krijimin e vakancës nga Këshilltari z.Gazmend Ramadan Çela, propozuar nga subjekti politik Partia Socialiste. Referuar nenit 164, pika 2 të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste e Shqipërisë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 22, zj. Grisilda Nexhip Plaka. Kandidati për këshilltar ka plotësuar formularin e vetëdeklarimit në KQZ. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë e cila ka të bëjë me parashikimet për ndalim në ligjin nr.138/2015. KQZ ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore dhe Zyra e Gjendjes Civile ku në përgjigje të kërkesës sonë Drejtoria e Përgjithshme e Gjendje Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore të

**Zbardhi materialin audio
Silvi SINO**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.13.04.2021*

kandidatit për anëtar të Këshillit të Bashkisë Vorë, i cili rezulton se nuk ka shënime në sistem. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk ka kthyer ende përgjigje. Referuar pikës 2, të kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se, të dhënat e kandidatit për anëtar, në Këshillin e Bashkisë Vorë, nuk përbëjnë kusht për mos zgjedhjen e saj në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Diskutime nga përfaqësuesit e partive? Nuk kemi. Mirë, atëherë bazuar në nenin 19 pika 1 dhe vijues të Kodit Zgjedhor vendos:

- 1.Zj. Grisilda Nexhip Plaka kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Vorë nuk përfshihet në kushtet e mos gjetshmërisë për ushtrimin e funksionit.
- 2.Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Vorë me kandidatin nga lista shumemërore PS zj. Grisilda Nexhip Plaka.
- 3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në KAS brenda 3 ditëve nga momenti i hyrjes së tij në fuqi.
4. Hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Vendimi nr.228

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.13.04.2021*

**13.04.2021
Ora 16:29**

RENDI I DITËS

**Projektvendim “Për miratimin e vëzhguesve afatshkurtër të organizatës
“Iniciativa për Veprime Sociale”, organizatës “Lëvizja Studentore për Barazi”,
për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 prill 2021”.**

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, V.Ballgjini, E.Allushi**
- **Parti Politike: PD, LSI**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën e fundit të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Korporata Austriake e Transmetimit (ORF), i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për akreditimin e 6 (gjashtë) gazetarëve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Albanian Post ka kërkuar akreditimin e 18 (tetëmbëdhjetë) gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit. Star Plus Television ka kërkuar akreditimin e 22 (njëzetë e dy) gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit. Reuters i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për akreditimin e 4 (katër) gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit. Gazeta Ora (First News Media) ka kërkuar akreditimin e 2 (dy) gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit. Gjithashtu Ambasada Bullgare ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 3 (tre) vëzhguesvë afatshkurtër. Ambasada Spanjolle ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 4 (katër) vëzhguesve afatshkurtër si dhe 2 (dy) përkthyesve. Ambasada Hollandeze ka

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.13.04.2021*

paraqitur kërkesën për akreditimin e 4 (katër) vëzhguesve afatshkurtër dhe 5 (pesë) përkthyesve. Gjithashtu oraganizata “Iniciativa për Veprime Sociale” (IVS) ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 51 (pesëdhjetë e një) vëzhguesve afatshkurtër, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Organizata “Lëvizja Studentore për Barazi, Studim, Kritikë, Veprim” (LSBSKV) ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 50 (pesëdhjetë) vëzhguesve afatshkurtër, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Misioni i Rrjetit Evropian të Organizatave dhe Monitorimit të Zgjedhjeve (ENEMO) ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 4 (katër) përkthyesve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Nga shqyrtimi i dokumentacionit i të gjithë këtyre organizatave dhe ambasadave, konstatohet se është në përputhje më nenin 6 të Kodit Zgjedhor dhe Udhëzimit nr.2 të vitit 2021 të KQZ. Gjithashtu Euro News Albania ka paraqitur kërkesë për akreditimin e 58 (pesëdhjetë e tetë) gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Mati TV ka paraqitur kërkesë për akreditimin e 7 (shtatë) gazetarëve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Gjithashtu ky dokumentacion është në përputhje më kriteret e përcaktuara ne nenin 6 të Kodit Zgjedhor dhe Udhëzimit nr.2 të vitit 2021 të KQZ. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim të të gjithë dokumentacionit të paraqitur, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Mirë, atëherë vendos:

- 1.Të miratoj kërkesën e organizatës “Iniciativa për Veprime Sociale” për akreditimin e 51 (pesëdhjetë e një) vëzhguesve afatshkurtër;
- 2.Të miratojë kërkesën e organizatës “Lëvizja Studentore për Barazi Studim Kritikë Veprim” për akreditimin e 50 (pesëdhjetë) vëzhguesve afatshkurtër;

Vendimi nr.229

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.13.04.2021*

**13.04.2021
Ora 16:29**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e përkthyesve të Misionit të ENEMO, për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, V.Ballgjini, E.Allushi**
- **Parti Politike:** **PD, LSI**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën e fundit të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Korporata Austriake e Transmetimit (ORF), i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për akreditimin e 6 (gjashtë) gazetarëve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Albanian Post ka kërkuar akreditimin e 18 (tetëmbëdhjetë) gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit. Star Plus Television ka kërkuar akreditimin e 22 (njëzetë e dy) gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit. Reuters i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për akreditimin e 4 (katër) gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit. Gazeta Ora (First News Media) ka kërkuar akreditimin e 2 (dy) gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit. Gjithashtu Ambasada Bullgare ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 3 (tre) vëzhguesvë afatshkurtër. Ambasada Spanjolle ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 4 (katër) vëzhguesve afatshkurtër si dhe 2 (dy) përkthyesve. Ambasada Hollandeze ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 4 (katër) vëzhguesve afatshkurtër dhe 5 (pesë)

Zbardhi materialin audio

Silvi SINO



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.13.04.2021*

përkthyesve. Gjithashtu oraganizata “Iniciativa për Veprime Sociale” (IVS) ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 51 (pesëdhjetë e një) vëzhguesve afatshkurtër, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Organizata “Lëvizja Studentore për Barazi, Studim, Kritikë, Veprim” (LSBSKV) ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 50 (pesëdhjetë) vëzhguesve afatshkurtër, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Misioni i Rrjetit Evropian të Organizatave dhe Monitorimit të Zgjedhjeve (ENEMO) ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 4 (katër) përkthyesve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Nga shqyrtimi i dokumentacionit i të gjithë këtyre organizatave dhe ambasadave, konstatohet se është në përputhje më nenin 6 të Kodit Zgjedhor dhe Udhëzimit nr.2 të vitit 2021 të KQZ. Gjithashtu Euro News Albania ka paraqitur kërkesë për akreditimin e 58 (pesëdhjetë e tetë) gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Mati TV ka paraqitur kërkesë për akreditimin e 7 (shtatë) gazetarëve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Gjithashtu ky dokumentacion është në përputhje më kriteret e përcaktuara ne nenin 6 të Kodit Zgjedhor dhe Udhëzimit nr.2 të vitit 2021 të KQZ. Bashkëlidhur keni projektvednimin për shqyrtim dhe miratim të të gjithë dokumentacionit të paraqitur, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Mirë, atëherë vendos:

1.Të miratojë kërkesën e misionit ENEMO për akreditimin e 4 (katër) përkthyesve për vëzhgimin e procesit zgjedhor.

Vendimi nr.230

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.13.04.2021*

**13.04.2021
Ora 16:29**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e gazetarëve të Korporatës Austriake të Transmetimit (ORF), Albanian Post, Star Plus television, Reuters, Gazeta Ora (First Media Network), Euronews Albania dhe Mati Tv, për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z.Illirjan Celibashi

2.Stafi KQZ: Y.Merkaj, M.Koja, V.Ballgjini, E.Allushi

• **Parti Politike: PD, LSI**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën e fundit të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Korporata Austriake e Transmetimit (ORF), i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për akreditimin e 6 (gjashtë) gazetarëve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Albanian Post ka kërkuar akreditimin e 18 (tetëmbëdhjetë) gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit. Star Plus Television ka kërkuar akreditimin e 22 (njëzetë e dy) gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit. Reuters i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për akreditimin e 4 (katër) gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit. Gazeta Ora (First News Media) ka kërkuar akreditimin e 2 (dy) gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit. Gjithashtu Ambasada Bullgare ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 3 (tre) vëzhguesvë afatshkurtër. Ambasada Spanjolle ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 4 (katër)

Zbardhi materialin audio

Silvi SINO



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.13.04.2021*

vëzhguesve afatshkurtër si dhe 2 (dy) përkthyesve. Ambasada Hollandeze ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 4 (katër) vëzhguesve afatshkurtër dhe 5 (pesë) përkthyesve. Gjithashtu oraganizata “Iniciativa për Veprime Sociale” (IVS) ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 51 (pesëdhjetë e një) vëzhguesve afatshkurtër, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Organizata “Lëvizja Studentore për Barazi, Studim, Kritikë, Veprim” (LSBSKV) ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 50 (pesëdhjetë) vëzhguesve afatshkurtër, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Misioni i Rrjetit Evropian të Organizatave dhe Monitorimit të Zgjedhjeve (ENEMO) ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 4 (katër) përkthyesve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Nga shqyrtimi i dokumentacionit i të gjithë këtyre organizatave dhe ambasadave, konstatohet se është në përputhje me nenin 6 të Kodit Zgjedhor dhe Udhëzimit nr.2 të vitit 2021 të KQZ. Gjithashtu Euro News Albania ka paraqitur kërkesë për akreditimin e 58 (pesëdhjetë e tetë) gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Mati TV ka paraqitur kërkesë për akreditimin e 7 (shtatë) gazetarëve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Gjithashtu ky dokumentacion është në përputhje me kriteret e përcaktuara ne nenin 6 të Kodit Zgjedhor dhe Udhëzimit nr.2 të vitit 2021 të KQZ. Bashkëlidhur keni projektvednimin për shqyrtim dhe miratim të të gjithë dokumentacionit të paraqitur, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Mirë, atëherë vendos:

- 1.Të miratojë kërkesën kërkesën e Korporatës Austriake të Transmetimit (ORF) për akreditimin e 6 (gjashtë) gazetarëve për vëzhgimin e procesit zgjedhor;
- 2.Të miratojë kërkesën e Albanian Post për akreditimin e 18 (tetëmbëdhjetë) gazetarëve për vëzhgimin e procesit zgjedhor;
- 3.Të miratojë kërkesën e Star Plus Televizion për akreditimin e 22 (njëzet e dy) gazetarëve;

Zbardhi materialin audio

Silvi SINO



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.13.04.2021*

4. Të miratojë kërkesën e REUTERS për akreditimin e 4 (katër) gazetarëve;
5. Të miratojë kërkesën e Gazeta Ora (First News Media Network) për akreditimin e 2 (dy) gazetarëve;
6. Të miratojë kërkesën e Euro News Albania për akreditimin e 58 (pesëdhjetë e tetë) gazetarëve;
7. Të miratojë kërkesën e “Mati TV” për akreditimin e 7 (shtatë) gazetarëve.

Vendimi nr.231

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.13.04.2021*

**13.04.2021
Ora 16:29**

RENDI I DITËS

**Projektvendim “Për miratimin e vëzhguesve afatshkurtër dhe përkthyesve të
Ambasadës Bullgare, të Ambasadës Spanjolle dhe të Ambasadës Hollandeze, për
vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”.**

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: Y.Merkaj, M.Koja, V.Ballgjini, E.Allushi**
- **Parti Politike: PD, LSI**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën e fundit të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Korporata Austriake e Transmetimit (ORF), i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për akreditimin e 6 (gjashtë) gazetarëve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Albanian Post ka kërkuar akreditimin e 18 (tetëmbëdhjetë) gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit. Star Plus Television ka kërkuar akreditimin e 22 (njëzetë e dy) gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit. Reuters i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për akreditimin e 4 (katër) gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit. Gazeta Ora (First News Media) ka kërkuar akreditimin e 2 (dy) gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit. Gjithashtu Ambasada Bullgare ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 3 (tre) vëzhguesvë afatshkurtër. Ambasada Spanjolle ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 4 (katër) vëzhguesve afatshkurtër si dhe 2 (dy) përkthyesve. Ambasada Hollandeze ka

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.13.04.2021*

paraqitur kërkesën për akreditimin e 4 (katër) vëzhguesve afatshkurtër dhe 5 (pesë) përkthyesve. Gjithashtu oraganizata “Iniciativa për Veprime Sociale” (IVS) ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 51 (pesëdhjetë e një) vëzhguesve afatshkurtër, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Organizata “Lëvizja Studentore për Barazi, Studim, Kritikë, Veprim” (LSBSKV) ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 50 (pesëdhjetë) vëzhguesve afatshkurtër, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Misioni i Rrjetit Evropian të Organizatave dhe Monitorimit të Zgjedhjeve (ENEMO) ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 4 (katër) përkthyesve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Nga shqyrtimi i dokumentacionit i të gjithë këtyre organizatave dhe ambasadave, konstatohet se është në përputhje me nenin 6 të Kodit Zgjedhor dhe Udhëzimit nr.2 të vitit 2021 të KQZ. Gjithashtu Euro News Albania ka paraqitur kërkesë për akreditimin e 58 (pesëdhjetë e tetë) gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Mati TV ka paraqitur kërkesë për akreditimin e 7 (shtatë) gazetarëve, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Gjithashtu ky dokumentacion është në përputhje me kriteret e përcaktuara ne nenin 6 të Kodit Zgjedhor dhe Udhëzimit nr.2 të vitit 2021 të KQZ. Bashkëlidhur keni projektvednimin për shqyrtim dhe miratim të të gjithë dokumentacionit të paraqitur, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Mirë, atëherë vendos:

- 1.Të miratojë kërkesën e Ambasadës Bullgare për akreditimin e 3 (tre) vëzhguesve;
- 2.Të miratojë kërkesën e Ambasadës Spanjolle për akreditimin e 4 (katër) vëzhguesve;
- 3.Të miratojë kërkesën e Ambasadës Hollandeze së Veriut për akreditimin e 3 (tre) vëzhguesve.

Këto janë, kemi kërkesa të tjera për vëzhgues. Përkthyesit? Dakord.

Faleminderit seanca mbyllet!

Vendimi nr.232

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.04.2021*

08.04.2021
Ora 14:06

RENDI I DITËS

Projektakti “Për shqyrtimin e denoncimit për moszbatim të vendimit nr. 140, datë 15.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ndaj Kryetarit të Bashkisë Vorë, zotit Gentian Picari”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi**
- **Parti Politike:** **LSI**
- **Bashkisë Vorë**
 - G.Picari (Kryetar i B/Vorë)**
 - E.Piero (Këshilltar i B/Vorë)**

Z. I. Celibashi: Mirëdita! Atëherë, fillojmë me shqyrtimin e çështjeve, të cilat në seancën e sotme publike në rend dite janë, projektvendimi “Për shqyrtimin e denoncimit për moszbatim të vendimit nr. 140, datë 15.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ndaj Kryetarit të Bashkisë Vorë, z. Gentian Picari”. “Për miratimin e gazetarëve të shoqërisë “Panorama Group”, të portalit “Bulqiza ime”, të televizionit “Top Channel” të Agjencisë Ndërkombëtare të Lajmeve “Associated Press” (AP), të Agjencisë Telegrafike Shqiptare (ATSH), të gazetës “SOT” për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 Prill 2021”. “Për miratimin e gazetarëve të Anadolu Agency (AA) për një shtesë në vendimin nr. 176, datë 23.03.2021 për miratimin e gazetarëve të televizionit A2 CNN për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 Prill 2021”. “Për miratimin e vëzhguesve

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.04.2021*

afatshkurtër të fondacionit “Së Bashku” për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 Prill 2021”. “Për miratimin e përkthyesve të misionit të OSBE/ODIHR për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 prill 2021”. “Për një shtesë në vendimin nr.151, datë 16.03.2021, “Për miratimin e vëzhguesve afatgjatë të misionit të OSBE/ODIHR për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 Prill 2021”. Atëherë, fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin e denoncimit për moszbatim të vendimit nr.140 datë 15.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ndaj Kryetarit të Bashkisë Vorë. Shkurt zoti sekretar!

Z. Y. Merkaj: Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur një denoncim nga Partia Lëvizja Socialiste për Integrim në datën 29.03.2021. Sipas denoncimit të kallzuesit pretendohet se Bashkia Vorë nuk ka zbatuar vendimin nr.140 datë 15.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Referuar nenit 82 të Kodit të Procedurave Administrative Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, çmon se të dhënat e paraqitura nga kallzuesi përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative. Në datën 15.03.2021, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr.140 ka marrë një vendimmarrje detyruese kundrejt Bashkisë Vorë, e cila duhet të merrte masa të menjëhershme dhe t’i për mbahej afatit të përcaktuar në nenin 71 pika 1 të Kodit Zgjedhor për rihapjen e faqes së internetit. Gjatë analizës së fakteve të shqyrtuara dhe provave të paraqitura nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmojmë se Bashkia Vorë edhe pas marrjes së vendimit nr.140 datë 15.03.2021 nuk ka hapur faqen aktive të internetit ku subjektet zgjedhore dhe publiku mund të marri informacionet e nevojshme sipas parashikimit të përcaktuar nga Kodi Zgjedhor. Referuar nenit 7 pika 1 germa c të vendimit numër 9 të vitit 2020 të Komisionit Rregullator, i cili përcakton sekretarët e përgjithshëm të institucioneve publike qendrore e vendore të pavarura e të varësisë, kryetarët e bashkive, prefektët

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.04.2021*

dhe drejtuesit e njësive administrative dhe drejtuesit e institucioneve të varësisë, të publikojnë të dhënat e tyre të kontaktit në faqen zyrtare përkatëse të internetit. Me qëllim administrimin e çdo denoncimi dhe të çdo rasti të përfshirjes, nxitjes, urdhërimit apo shantazhit. Kërkesës për përfshirjen e punonjësve të atij institucioni në veprimtari politike apo në mbështetje të një subjekti zgjedhor apo të kandidatit në zgjedhje. Kjo dispozitë nuk është zbatuar nga Bashkia Vorë, referuar nenit 79 pika 1 të Kodit Zgjedhor përcaktohet se jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve Kryetari i Bashkisë në mënyrë të drejtë dhe të pa anshme përcakton vendet publike në territorin e bashkisë përkatëse për afishimin prej partive politike dhe subjekteve zgjedhore të materialeve propagandistike, vendet e caktuara duhet të jenë në ambiente që të sigurojnë shikueshmëri publike dhe të kenë hapsirë të mjaftueshme, ku të gjitha subjektet zgjedhore që marrin pjesë në zgjedhje të paraqesin programet e tyre zgjedhore dhe mesazhet zgjedhore. Vendimi i Kryetarit të Bashkisë bëhet publik në faqen e internetit të bashkisë menjëherë pas miratimit. Për sa më sipër në zbatim të nenit 79 pika 1 të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr.9 të vitit 2020 të Komisionit Rregullator me qëllim administrimin e çdo denoncimi dhe të çdo rasti të përfshirjes, nxitje, urdhërimi apo shantazhimi Bashkia Vorë duhet të merrte masa të menjëhershme dhe t'i përmbahej afatit të përcaktuar nenit 79 pika 1 për rihapjen e faqes së internetit. Referuar nenit 171 pika 1 të Kodit Zgjedhor parashikohet se shkelja e dispozitave të Kodit Zgjedhor nga anëtarët e Komisioneve Zgjedhore ose personat e ngarkuar me detyra sipas këtij kodi kur nuk përbëjnë vepër penale dënohen me gjobë nga 3 mijë deri në 90 mijë lekë. Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 79 pika 1 të Kodit Zgjedhor përcakton se mos marrja e masave të nevojshme, brenda afateve të përcaktuara për publikimin e vendimeve të Bashkisë Vorë për caktimin e vendëve për afishimin e

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.04.2021*

materialeve propagandistike ngarkon me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë Vorë si subjekt i ngarkuar për zbatimin e këtij ligji.

Z. I. Celibashi: Është njoftuar Kryetari i Bashkisë Vorë?

Z. Y. Merkaj: Është prezent në sallë.

Z. I. Celibashi: Ju jeni, dakord! Ne kemi bërë një shkresë edhe për një informacion para disa kohësh për këtë apo jo?

Znj. M. Koja: Zoti Komisioner përpara rreth një muaj ka pasur një kallëzim tjetër nga i njejtë denoncues dhe ju keni disponuar me vendim për të marrë masa të menjëhershme për të hapur faqen e internetit.

Z. I. Celibashi: Po, faleminderit! Mirë, dakord. Atëherë meqenëse është prezent edhe Kryetari i Bashkisë Vorë zoti Gentian Picari i japim fjalën për të prezantuar mendimin e tij dhe opinionin e tij në lidhje me këtë procedim administrativ.

Z. Gentian Picari, Kryetari i Bashkisë Vorë: Faleminderit zoti Komisioner! Pasi jemi vënë në dijeni të denoncimit nga Lëvizja Socialiste për Integrim, kemi marrë të gjitha hapat që parashikon ligji për të riaktivizuar faqen e Bashkisë Vorë. Kam një relacion të shkurtër përsa i përket të gjithë shkresave që janë bërë edhe agjencive të cilat krijojnë mundësinë e aktivizimit të faqes së ËEB-it. Kemi mbajtur korrespondencë si elektronike po ashtu edhe shkresore. Këtu kemi një kronologji të të gjithë shkresave duke filluar nga data 06.01.2021, të cilët i jemi adresuar me një shkresë më numër protokolli 333 AKSH-it për suport teknik dhe IKUB-it në

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.04.2021*

bashkëpunim, si dy agjenci të cilët kanë të drejtë të riaktivizojnë faqen. Për këtë s'kemi akoma një përgjigje. Po ashtu në datë 12.01 është bërë një shkresë sërish nga IT-ja e bashkisë, edhe këtu nuk kemi përgjigje. Pra kam një sërë shkresash të cilat janë drejtuar agjencive për të riaktivizuar faqen e ËEB-it. Dua të theksojë diçka, që me gjithë vullnetin dhe detyrimin ligjor që ka bashkia për të aktivizuar faqen e ËEB-it duke qënë se është një institucion shtetëror e ka të pamundur ta riaktivizojë jashtë këtyre dy kanaleve institucionale që është AKSH-i dhe AKEP-i. Kjo dhe arsyeja, kemi paraqitur dhe të gjithë shkresat. Po ashtu kemi paraqitur edhe si nevojë emergjente rinovimin e faqes, edhe në projektbuxhetin që kemi propozuar për këtë vit, si nevojë emergjente. Kjo është e gjithë situata.

Z. I. Celibashi: Po, mirë ju keni marrë përgjigje, qoftë nga AKSH-i, qoftë nga AKEP-i? Asnjë përgjigje?!

Z. Gentian Picari, Kryetari i Bashkisë Vorë: Ja ku i kemi të gjithë shkresat drejtuar AKSH-it dhe AKEP-it. Kemi vënë në dijeni dhe Komisionin Qendor të Zgjedhjeve për këtë, kërkesë 16.01.2021, 12.01, dhe këtu kemi dhe të gjithë komunikimin zyrtarë që i'a kemi adresuar agjencisë kombëtare AKSH-i dhe AKEP-i, që janë pa përgjigje, nga drejtorja jonë e IT-së si bashki. Kjo është situata.

Z. I. Celibashi: Ne i disponojmë këto komunikimet ndërmjet Bashkisë Vorë dhe...

Znj. M. Koja: Gjatë hetimit administrativ të kallëzimit të parë i kemi administruar, dhe prandaj dolëm me rekomandimin dhe detyrën për Bashkinë Vorë për të marrë masat operative për t'a vënë në funksion faqen. Ndërsa pas denoncimit të dytë, ne

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.04.2021*

verifikuam dhe vetë dhe faqja nuk ishte ende e hapur. Nëse ka të tjera përposë atyre që kanë dorëzuar gjatë hetimit të parë administrativ, atëhere ato ne nuk i kemi.

Z. I. Celibashi: Ka të tjera pas komunikimit të parë?

Z. E. Piero, Këshilltar i Kryetarit të Bashkisë Vorë: Nëse më lejohet të flas zoti Komisioner? Faqja e ËEB-it që disponon sot Bashkia Vorë është e dhuruar nga USAID-i, është e regjistruar në AKSH-i, dhe është e përpunuar apo e zhvilluar nga IKUB-i. Kredencialet për të bërë ndërhyrje, për të bërë mundësinë që të punojmë mbi atë, duhet të marrim një leje tek AKSH-i, dhe tek AKEP-i. Për të gjitha këto gjëra zyrtarisht nga ana e bashkisë është kërkuar leja dhe miratimi që në të ndërhyrjmë, po nuk kemi asnjë lloj përgjigje. Me shkresën e fundit 3035 në dispozicion të Komisionit Qendror janë vendosur, absolutisht që të gjitha dokumentacioni dhe e-maile elektronike zyrtare të dërguara qoftë nga bashkia dhe kthim përgjigjet sporadike duke përcjellë problemin sa tek njëri tek tjetri. Pra, nuk është në mosdëshirën apo veprim apo mosveprimin e bashkisë sepse është në duart e institucioneve të tjera.

Z. I. Celibashi: Kuptova. Përfaqësuesi i Lëvizjes Socialiste për Integrim në cilësinë e palës së interesuar në këtë procedim.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Faleminderit zoti Komisioner. Ashtu si relatoi dhe Kryetari i Bashkisë kemi pasur një, ndonëse një iniciativë nga ana e tij për të komunikuar me autoritetet përgjegjëse për hapjen e kësaj faqeje, por nuk kemi pasur vullnetin e tij të mirë nga ana e tij për vënien në dispozicion të këtij informacioni ose pamundësisë për arritjen e qëllimit. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.04.2021*

paraprakisht në përmbushje të dispozitave të Kodit Zgjedhor neni 71, pika 1, të nenit 7 pika 1, germa “ç” i Komisionit Rregullator numër 9-të të vitit 2020-tës, pra deridiku i gjen justifikime këto. Dua të sjellë në vëmendje tuaj zoti Komisioner, që është bërë e qëllimshme kjo gjë, pavarësisht korrespondencës administrative që kanë pasur palët në këtë rast. Në dijeninë tonë ky rast është shfrytëzuar dhe për të selektuar personat, qytetarët e Bashkisë Vorë për dhënien e ndihmës së tërmetit, të fatkeqësisë natyrore që ndodhi në atë bashki, se ka qënë detyrim njoftimi i qytetarëve të cilët i janë prekur bizneset ose pronat nga pjesa e tërmetit të Nëntorit 2020-të në qoftëse nuk gaboj, 2019-të. Fakti është që në dijeninë tonë i gjithë procesi duke filluar nga mbledhja e dokumentacionit dhe dhënia e shpërblimit është bërë nga Kryetari i Bashkisë Vorë në mënyrë selektive. Pra dhe ka ndihmuar mospasja e faqes dhe mosdhënia e dijenisë së qytetarëve në mënyrë masive dhe në mënyrë të drejtë, ashtu siç duhet të ishte ligjërisht në bërjen e disa selektimeve kundrejt dhënies së shpërblimit vetëm të anëtarëve të një partie politike, partisë në pushtet. Përsa i përket pjesës së thelbit të ankesës tonë, ne i jemi drejtuar këtij Komisioni nëpërmjet jush, si përfaqësuesi më i lartë i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve përsa i përket pjesës së marrëdhënieve me të tretët ashtu siç parashikohet në ligj me dy denoncime. Fillimisht me denoncimin e parë që ju e keni marrë në shqyrtim. Dhe nga verifikimi i bërë nga inspektorët tuaj keni dalë në konkluzionin parashikuar në vendimin tuaj numër 140-të datë 15 Mars 2021 ku Kryetarit të Bashkisë Vorë i jepet ashtu si relatoi edhe drejtoresha, një paralajmërim për marrjen e masave të menjëhershme për vënien në ligjshmëri të kësaj paligjshmërie. Pra, nga ai çast deri më sot nuk kemi pasur marrje masash. Pavarësisht justifikimeve që mund të ngrejë këtu Kryetari i Bashkisë, Lëvizja Socialiste për Integrim i është drejtuar me një ankësë tjejtër Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve e cila mban datën 29 Mars 2021, protokolluar pranë KQZ-së, me numër protokolli 2798, datë 29.03.2021, ku kërkojmë, që në bazë

*Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.04.2021**

të vendimit që është marrë nga ana juaj 140, datë 15.03.2021, në kushtet kur pas kalimit të një afati 15 ditor nga vendimmarrja juaj, siatuata e paligjshmërisë vazhdon në këtë bashki, kërkojmë sanksionimin administrativ të personit përgjegjës në këtë rast, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Vorë sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor. Jemi ftuar në këtë seancë dëgjimore në cilësinë e palës së tretë ku nga aktet administrative të gjeneruara nga ana juaj, dhe nga denoncimi i bërë nga ana jonë ka një përputhshmëri të plotë të paligjshmërisë së kërkuar në titullin e ankesës. Kështu që mendojmë që përpara këtij fakti dhe qëllimshmërisë së kësaj bashkie për të arritur disa qëllime elektorale devijuese të ligjit. Ju duhet të veproni nëpërmjet sanksionimit administrativ ashtu siç parashikohet në ligj. Faleminderit!


Z. I. Celibashi: Faleminderit! Kryetari i Bashkisë ose përfaqësuesi ka diçka për të shtuar?

Z. Gentian Picari, Kryetari i Bashkisë Vorë: Po, kam diçka për të shtuar, përse pretendoi subjekti politik që ka paraqitur ankesën, është në dijeni këtu nuk mund që të flasi me fjalë, por duhet të ketë disa prova shkresore të cilat bashkia i ka paraqitur. Së dyti në lidhje me pretendimin për pjesën e shpërblimeve apo granteve të tërmetit, në pamundësi

Z. I. Celibashi: Jo, nuk do të merremi me atë, nuk është objekti i këtij shqyrtimi kjo gjë.

Z. Gentian Picari, Kryetari i Bashkisë Vorë: Në rregull. Tek pjesa e njoftimeve publike ka një stendë që parashikon procedura administrative që parashikon njoftimi publik. Dhe nga ana jonë është respektuar si me pjesën e miratuar me vendim të

**Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI**



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.08.04.2021**

Kryetarit të Bashkisë për stendën e objektivë propagandistike për rastin e zgjedhjeve si dhe me pjesën e komunikimeve shkresore për rastin e faqes së internetit mbi të cilin ata kanë paraqitur ankesë. Përsa më sipër nuk mendoj se është e drejtë ankesa e subjektit politik ndaj Bashkisë Vorë.

Z. I. Celibashi: Çfarë dokumentacioni ose provash të tjera keni për të depozituar, depozitohuni. Nuk e di, dhe përfaqësuesi i Lëvizjes Socialiste për Integrim ka dokumente të tjera?

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Nuk kemi asnjë provë, ne jemi përpara faktit që të pohuar dhe në këtë seancë dëgjimore përpara jush, që arritja e qëllimit nuk ka konkluduar, pra nuk është bërë, nuk është vënë në efikasitet një detyrim ligjor për vënien në dispozicion të qytetarëve të një sajti interneti në përmbushjen e detyrave të përcaktuara të Kryetarit të Bashkisë. Ky është fakt, dhe fakti i pohuar dhe vetë nga pala, kështu që s'ka më nevojë të provohet.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëherë do të depozitoni të gjitha provat që në vlerësimin tuaj janë të tilla, dhe me këtë rast e konsiderojë të përfunduar hetimin administrative. Vendimin do ta shpallim ditën e Hënë në datë 12 Prill, nëse nuk gaboju 12-të është, në ora 13:00. Faleminderit! Mbyllet kjo pikë e rendit të ditës.

**Zbardhi materialin audio
Ardita VRIONI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2021*

12.04.2021
Ora 13:30

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e denoncimit për moszbatim të vendimit nr.140, datë 15.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ndaj Kryetarit të Bashkisë Vorë, z. Gentian Picari”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi, V.Ballgjini**
- **Parti Politike: PD, LSI**

Z. I. Celibashi: Mirëdita, fillojmë me shqyrtimin e çështjeve të cilat kemi në rendin e ditës së mbledhjes së Komisionerit Shtetëror për ditën e sotme, Nga mbledhja e kaluar kemi:

- 1.Projektvendimin për shqyrtimin e denoncimit për moszbatim të vendimit nr.140 datë 15.03.2021 të Komisionerit Shtetëror ndaj Kryetarit të Bashkisë Vorë.
- 2.Shqyrtimin e raportit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.
- 3.Projektvendim për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lezhë.
- 4.Projektvendim për plotësimin e vakancës në Bashkinë Kamëz.
- 5.Projektvendim që ka të bëjë me miratimin e procedurave të dorëzimit të kamerave për videoregjistrimin në mjediset e brendshme të qendrës së votimit dhe
- 6.Miratimi i disa vëzhguesve për zgjedhje.

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2021*

Atëherë, fillojmë me pikën e parë që në fakt është vazhdimi i pikës së rendit të ditës së mbledhjes së shkuar që ka të bëjë me denoncimin ndaj Kryetarit të Bashkisë Vorë. Nuk ka ardhur përfaqësuesi i bashkisë?

Z. Y. Merkaç: Jo. Pranë KQZ-së është paraqitur një kërkesë për informacion mbi problematikën që ka pasur në faqen e Web-it në datën e sotme. Bashkëlidhur edhe një kërkesë që ka dërguar në datën 1.04.2021 Agjensisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit. Këto dy kërkesa kemi.

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesit të LSI, ia dhatë një kopje? Jeni njohur me të?

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Po, unë jam njohur me të, shoh një kërkesë drejtuar jush, protokolluar më datë 12.04.2021 me lëndë informacion mbi problematikën e faqes zyrtare të Web-it Bashkisë Vorë dhe një kërkesë bashkëlidhur nga Bashkia Vorë për suport teknik drejtuar Agjensisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit. Ndërkohë që kjo është thjeshtë një shkresë e bashkisë dhe nuk kemi korrespondencë protokollare në mënyrë që është vënë në dispozicion të institucionit përkatës, shoh një tendencë të Bashkisë Vorë për të zvaritur këtë proces dhe për të mos mbajtur përgjegjësi. Shkresa mban datën 7.04.2021 drejtuar jush dhe 1.04.2021 drejtuar AKSH-it ndërkohë që është një detyrim që i lind bashkisë shumë më përpara se kjo datë, ndërkohë që shohim tendencë të qartë për të anashkaluar ligjin për të moszbatuar atë dhe duke zvarritur procesin në vetvete duke hedhur përgjegjësi tek institucionet e tjera, të cilat në këtë rast flasin për përgjegjësi individuale të kryetarit të bashkisë si personi përgjegjës për moszbatimin e aktit me karakter normativ dhe nenit 79 të Kodit Zgjedhor.

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.12.04.2021*

Z. I. Celibashi: Atëherë shkresa dërguar në KQZ në datën 7.04.2021 shkresa që i ka dërguar AKSH-it është e datës 1.04.2021. Atëherë, unë mendoj që ne ta rihapim hetimin administativ dhe t'i kërkojmë AKSH-it një informacion në lidhje me sa është pretenduar nga Kryetari i Bashkisë Vorë. T'i dërgojmë një kërkesë për informacion brenda datës 14.04.2021. Të lemë seancën tjetër për këtë, data 14.04.2021 ora 12:00.

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.14.04.2021*

**14.04.2021
Ora 12:05**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shqyrtimin e denoncimit për moszbatim të vendimit nr.140, datë 15.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ndaj Kryetarit të Bashkisë Vorë, z. Gentian Picari”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja**
- **Parti Politike:** **LSI**

Z. I. Celibashi: Mirëdita, fillojmë me shqyrtimin e çështjes në rendin e ditës e cila ka të bëjë me moszbatim të vendimit nr.140, datë 15.03.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ndaj Kryetarit të Bashkisë Vorë. E kemi shtyrë seancën për të kërkuar një informacion nga AKSH-i në lidhje me pretendimet e paraqitura nga Kryetari i Bashkisë Vorë për mosrealizimin e faqes së internetit të institucionit të Bashkisë Vorë. E kemi përgjigjen nga AKSH-i?

Z. Y. Merkaj: Po.

Z. I. Celibashi: Bëjmë një relatim në lidhje me përmbajtjen.

Z. Y. Merkaj: Në datën 13.04.2021 i kemi dërguar një kërkesë AKSH-it për informacion në lidhje me pretendimet e Kryetarit të Bashkisë Vorë. Në përgjigje të

Zbardhi materialin audio

Silvi SINO



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.14.04.2021*

kërkesës sonë, AKSH-i ka kthyer përgjigje që Web-Site i Bashkisë Vorë është pjesë e projektit “Planin Project, Governin Project”. Ky është projekt midis bashkisë dhe operatorit ekonomik që ka fituar të drejtën e zhvillimit dhe implementimit të projektit. Në këtë rast AKSH-i ka kontribuar në project duke vënë resurset natyrore në formën e serverave virtual të dedikuar. Pra, “ne” thotë AKSH-i garantojmë vetëm kushtet optimale të resurseve infrastrukturore dhe komunikimit. Përgjegjësia rreth përmbajtjes së shërbimeve dhe shërbimeve që ofrohet nga këto servera është e Bashkisë Vorë. Në komunikimet elektronike AKSH-it i është kërkuar diagnostifikimi i problemit, ku ne kemi konfirmuar se resurset infrastrukturore dhe komunikimi janë në gjendje optimale dhe problemi qëndron në nivel shërbimi brenda, në server. Përgjegjësia është jashtë AKSH-it. Kjo është përgjigjja që ka kthyer AKSH-i.

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesi i LSI-së?

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Po, faleminderit zoti Komisioner, nga sa shohim nga përgjigjja që relatoj Sekretari i Përgjithshëm, praktikisht AKSH-i ka ngarkuar me përgjegjësi Bashkinë Vorë. Qartazi del që ato që kanë qenë në titullin e parashtrimeve nëpërmjet dokumentacionit të vënë në dispozicion Komisionerit, kanë qenë një anashkalim përgjegjësie i konfirmuar në shkresën e AKSH-it. Kështu që duke mos pasur asnjë përgjegjësi AKSH-i në këtë situatë të krijuar parashikuar në nenin 79, të Kodit Zgjedhor dhe aktet rregulluese të tij, ftojme Komisionerin të shprehet me vendim duke sanksionuar administrativisht Kryetarin e Bashkisë Vorë si personi përgjegjës për këtë shkelje.

Zbardhi materialin audio

Silvi SINO



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.14.04.2021*

Z. I. Celibashi: Atëherë, e konsideroj të mbyllur shqyrtimin, hetimin administrativ. Referuar palëve në këtë shqyrtim dhe bazuar në provat e administruara në këtë shqyrtim administrativ si dhe neni 19, paragrafi 1, shkronja “dh”, “f”, “n” paragrafi 2, neni 79, pika 1, neni 92, neni 171, pika 1, të Kodit Zgjedhor si dhe nenit 60 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative, vendos:

- 1.Sanksion Administrativ me gjobë ndaj zotit Gentian Picari, Kryetar i Bashkisë Vorë me shumën 10000 (dhjetë mijë) lekë;
 - 2.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në KAS brenda 3 (tre) ditëve nga data e njoftimit të këtij vendimi;
 - 3.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
- Faleminderit, seanca mbyllet!

Vendimi nr.234

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*

